



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 25, datë 31.07.2024

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:

**“RESORT TURISTIK, REZIDENCIAL, HOTELERI DHE SHËRBIME DHE SHITESË
NËNTOKË NË OBJEKT EKZISTUES (HOTEL SEA VIEW), ZONAA (OBJEKTI 1 DHE
2), ZONA B (OBJEKTI 3), ZONA C (OBJEKTI 4 DHE 5), ZONA E (OBJEKTI 6), ME
VENDNDODHJE NË POTAM, BASHKIA HIMARË”**

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” e ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Bega-07” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të lejes së ndërtimit për objektin: “Resort turistik, rezidencial, hoteleri dhe shërbime dhe shtesë nëntokë në objekt ekzistues (Hotel Sea View), Zona A (Objekti 1 dhe 2), Zona B (Objekti 3), Zona C (Objekti 4 dhe 5), Zona E (Objekti 6), me vendndodhje në Potam, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Bega-07” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Himarë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 02/05 2025